

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I TRETË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

# WORKS

III

Editorial board:

Ali Aliu, editor  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I TRETË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013







# HIJA E TOKËS

Bota e re, Prishtinë, 1971

*A tyre që u bënë liria jonë*

Me respekt e admirim  
B. Currit, A. Vokshit, E. Durakut,  
G. Tërbeshit, M. Bakiut...

*autori*

Cikli i parë nga “Hija e tokës” është botuar për herë të parë më 1961 në revistën “Jeta e re” – numër 1. Ndërkaq më 1968 është përkthyer e botuar në gjuhën serbokroate e maqedone me titull “Metohi – kullë e lartë”.



## I.

(EPIKA)

Pesë shekuj kam shitur gjakun  
e rritur jam me gjakun e shitur.

Merre me mend –  
pesë shekuj kam hëngër veten

dhe s'kam ditur të qesh  
me veten e tepruar.

Miq,  
Kosova është gjaku im që nuk falet!

1. (UNË, BIRI YT)

Unë, biri yt, Kosovë, t'i njoh dëshirat e heshtura,  
t'i njoh ëndrrat e tua, erërat e fjetura me shekuj.

Unë, biri yt, Kosovë, t'i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet,  
t'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua të kallura.

Unë, biri yt, Kosovë, ta di gjakun që të vlon në gji,  
dallgën kur të rrahë netëve t'pa gjumë  
e të shpërthejë do si vullkan.

Unë, biri yt, më mirë se kushdo tjetër të njoh, Kosovë.

## 2. (SHTËPIA IME PA QETËSI)

Shtëpia ime prej kashte, prej balte;  
shtëpia ime prej vuajtje;  
shtëpia ime prej gëzimit;  
shtëpia ime me një bisht dhe.

Gjel, kur ti kërcen tra e m'tra  
thonë – moti ndërron,  
gjeli im i untë,  
kur ti kërcen tra e m'tra.

Shtëpia ime prej kashte, prej balte;  
shtëpia ime vuajtje;  
shtëpia ime prej gëzimit –  
shtëpia ime pa qetësi.

### 3. (IKËN PËLLUMBAT)

Ikën pëllumbat, do çerdhe i dogj juga...  
Flaka e eshtrave të mi sa e ndritshme qenka,  
në kandar të dhembjeve sa rëndë po heq.

Askush s'do t'mbesë gjallë  
në këtë lojë zjarri, askush s'do t'mbesë  
në pusi të shtatë bjeshkëve 'i kulshedër vrâ e kallë.

Hej, ç'mu thyen brinjtë duke qeshur...  
A do të kthehen pëllumbat më  
apo do të shtypet edhe koka ime e mbramë?

Emri im, mbaju – shumë e kurtha është kurdisur për ty!

#### 4. (HIJA E TOKËS)

Ara e misrit është kallur  
(nata si kalë hamshor nga ka  
jashtë e brendë shtëpisë sime,  
me mua nga ka e ara e misrit kallur është)

dhe livadhi rrëzë shtëpisë  
dhe vreshta ime e vogël  
dhe plepi –  
ajo hije e tokës sime,

gjithë natën e lume kallur janë  
me sytë e mi të përgjakur.

Ara e misrit është herrur,  
plepi ka rënë  
dhe zogu im i mbramë.

Unë kam kafshuar heshtjen  
dhe numëruar kam minutat e vdekjes sime.  
në pragun e shtëpisë së rrëzuar.

– O, si ta ndjell atë zog të bardhë,  
si të bëhem dritë, o vëlla, mbi varrin tënd?

Medet, blerimi na i dogj krejt  
fushat e bukës  
dhe livadhet tona.

5. (ANK' TH)

Toka ime po digjet – toka jonë e dashur,  
balli im i ngrysur si pisha m'kallet!

Caqet e tua, të rimura me gjak e lot, herët t'i kam përbirë  
me hijet e mia,

Kosovë, përrallë e lashtë!  
Herët m'i ke lidhur këmbë e duar me skamje,  
vuajtje e vdekje...

Medet, kë më parë ta shpëtoj: veten apo zogitë e ngrirë n'ajër?  
Nipave ç't'u them për këngën time të vdekjes?  
– Heu, edhe kryet sikur t'ma hiqshit,  
tjetri kishte për t'm'birë!

Toka ime po digjet –  
në çdo pëllëmbë të trupit tim: dashuri e urrejtje;  
në çdo pëllëmbë të trupit tim –  
toka jonë e mallëkuar –

Mbretër, sulltanë rreth teje, sa ushtrinëlanë,  
emri im!

## 6. (PËRTEJ DHEMBJES)

Kam rënë si dega e thyer prej reje në  
trupin tënd të shituar, Kosovë.

Konaqet e tua deri në temel po rrënohen  
e përtej dhembjes do britje po shemben me ballin tim,  
me krahët e zogut tim të vrarë, me da-  
shurin e njerëzve të mi të kallur etjeje.

Rreth trupit tënd si gjarpër mbështjellë jam  
vatrat e shkimbura për t'i përflakur,  
duar e këmbë që t'i lidh me lëmshin e  
përrallave të tua – se s'të lëshoj gjallë  
me gjak pa të larë pëllëmbë për pëllëmbë,  
eshtra e jetë në ty pa i lënë,  
konak e më konak pa të ndezur flakë...

Kam rënë si dega e thyer prej reje në trupin tënd të shituar  
– prej pushkës së parë,  
prej pushkës së mbramë...

O, cila do të jetë kënga ime e mbramë  
dhe fjala e fisit tim?

Plepi i shtëpisë sime u dogj,  
ku t'i preh sytë,  
ku ta shuaj flakën e ujës për ty, Kosovë?



## 7. (I PANJOHURI)

Dikush trenisht po nget ta shkimbë shkë-  
ndijën e ballit tim dhe sytë e tu,

dikush trenisht po m'i kallë rrembat e  
trupit e një nga një zogjtë po m'i vret

dikush prej agimit në agim, prej muzgut në muzg  
veten po përbin buzë një lumi...

Ne akoma emrin s'ja mësuam  
e një ditë me shi hyri n'kullën tonë.

## 8. (TOKA JONË E FËMIJËVE TANË)

Toka jonë e varret tona pa emër,  
Toka jonë gërhamë e gjokseve të shterrura.  
Toka jonë e shurdhët, e mallëkuar.  
Toka jonë e dashurive tona, e flamujvenë hava.  
Toka jonë e vajtimeve tona, e këngëve tona.  
Toka jonë e fëmijëve tanë t'palindur.  
Toka jonë dielli ynë i pikëllimit, dielli ynë i gëzimit.  
Toka jonë – fisi yt i shkimbur, gjaksor.

## 9. (REVOLUCIONET)

Drini i Bardhë: kuq, kuq, kuq...

Qeni im i zi po leh,  
qiellin do ta përbijë;

qeni im i bardhë  
qeni im i zi pa sy e dhëmbë.

Drini i Bardhë: kuq, kuq, kuq...

Zogu im

në kupë të qiellit  
është ngjitur.

## 10. (RRËFIMI)

Nëna ime ka vdekur,  
n'drita të syve duke u betuar, në krye tim e të vëllaut,  
në korën e bukës e të kripës –  
nëna ime e dashur.

Babai im është vrarë në megjë të arës me fqijun grabitës,  
vadën duke ndalur për livadhin tonë, për arën –  
për bukën e motmotit,  
E vëllau im kurrë s'ka kthyer prej mërgimit.

Motra ime nëntë ditë rrugë larg është dhënë,  
atje kullën e gëzimit ka ngrehur –  
këngën e vajit e ka kallur.  
E – unë çdo ditë kam pritur atë ditë të vonuar.

Nëna ime, babai im, motra ime, vëllau im, pa emër.

## 11. (RËNKIMI)

Qaj, rrafshi im i dashur, qaj!  
Diellin tënd verbuar ta kanë tytat  
e vatrat shkimbur deri në një;  
zogun në qiell vrarë ta kanë –  
me duar të mia të çara,  
me rrashta tona t'shpuara mbuluar t'kanë.

Qaj,  
rrafshi im i dashur, qaj!  
Në flakën e oxhakut, t'oxhaqeve tona  
therë e pjekur kanë deshtë me këmborë,  
pragje thyer e konaqe mbyllur.  
gjakun pijë na kanë në sofrën tonë  
e na – vdekur kemi për mbretër, sulltanë...

Qaj,  
rrafshi im i dashur, qaj!  
Gjak e rrashta në ty kam shkelur  
konak e më konak duke të të rënë;  
dasmën me dy tre krushqi e kam bërë  
e dekën jashtë pragut si sytë e ballit  
nxjerrë e kam kur na kanë gjuajtur,  
kur na kanë vrarë.

O, qaj tokë e dashur, qaj!  
Plepi im qiellin do të shpojë,  
plepi im i kallur –  
qiellin e humbur maje një shpate.

12. (NINULLË GURI)

Flej, syshkruari im,  
sykalluri i Kosovës!  
Flej, ujku im!

Dita do të agojë –

e zemrën, e shpirtin  
e shkëmbit  
ka për ta falur.

Flej fytyrëvrari im!  
Flej, shkabë e maleve,  
biri i nënës sate t'vdekur!

Zjarri po na zgjon nga ëndrra

13. (MALLKIMI)

Mos m'i shtyp sytë  
t'u shkurtoftë jeta!  
– Vaj, t'i shoh festat

e bjeshkëve të mia...

Mos m'i shtyp sytë  
t'u shkurtoftë jeta!  
– Vaj, së paku le të ngihen

me qeshjet e mia...

Mos! Le akoma s'kam.



14. (NJË NATË NGA NETËT PA GJUMË)

Zgjoju, Kosovë! Zgjoju, nëna ime e dashur,  
balli dhe emri im i shkelur –  
zgjoju, oj! A po e ndien vajin tim?  
A po sheh si t'i kam ngulur sytë  
mu në zemër, mu në shpirt,  
si t'i kam hedhur duart rreth belit  
për të përqaftuar, unë – ashti yt?  
Zgjoju, Kosovë!  
Prej degëve të mia të thyera kush po bahet,  
këtë vatër kush po e lë?  
Ç'janë këto gjurma gjaku që po shtohen  
nëpër fytyrën tënde,  
këto varre e murana që po sillen  
rreth shtëpisë sime?..  
Zgjoju, Kosovë! Zgjoju, nëna ime e dashur,  
balli dhe emri im i shkelur –  
Zgjoju, Kosovë!..  
Sonte vetëm mbeta e –  
në derë të oborrit askush më s'po më troket,  
askush më, thua vdekur jam e harruar

në këto troje e suka gjaku;  
thua më është shkimbur hisja  
e mbyllur dera e konakut,  
Zgjoju, Kosovë – flakë e hershme e ashtit tim t'pëlcitur.  
Bota në ty le të kallet!

## II

### 1. (ZOGU)

Cila është kënga jote  
zogu im që m'grish –  
kur ti fluturon, kur ti fluturon  
mbi shtëpinë time?

Me vete çka sjell  
kur në shtëpinë time bie,  
zogu im i bardhë,  
kur në shtëpinë time pushon?

Cila është porosia jote  
kur m'ik, kur m'lë  
fole të thatë pa këngë,  
zogu im i shenjtë?...

Zërin s'ta ndjeva asnjëherë  
e bukura jote më shitoi,  
zog zogu, më lë të qetë s'paku t'vdes –  
fluturimi yt përrallë qenka.

## 2. (KAH RRIDHTE GJAKU)

Toka jonë orë e kohërave.

Në mënyrë të çuditshme  
munduar jemi të jetojmë  
na të ndjekurit,  
na të vrarët

nëpër shekuj e mote.

Sa mendonim se jetonim  
shkelte gjakësori në tokën tonë  
me breshërin e mbrëmjeve të ujkut  
e na i digjte flakë bajraqet.

Na niseshemi atëherë në gjurmët e një kalorësi  
pas një nusje të mplakur në përralla tona,  
na dasmorët e dasmave të mallëkuara,  
niseshemi kah rridhte gjaku –

se toka jonë orë e kohërave

### 3. (QENI IM KA LEHUR NË SHUSHURIMËN E PLEPAVE)

Tërë jetën çelur kam varre –  
djali im si palaço  
argëtuar ka fëmjët e zotërinjve t'panjohur.  
Ku miza bren hekur  
ngritur kam kulla  
e vajza ime memece  
deri u çmend ka kënduar për zotërinj të rinj.  
Nëpër dritën e hënës  
të lashtat e mia  
prerë i ka drapri i ndryshkur i të huajit.  
Qeni im ka lehur  
në shushurimën e plepave,  
lehur ka gjatë  
në rektimat e natës sime mordare.  
Tërë jetën kam çelur varre –  
Azi e Evropë  
mbjellë kam me eshtra të mi.

#### 4. (VARRE LANË PAS)

Një ditë më thanë:

– Ndërroje ngjyrën e syve,  
sytë e tu ngjyrën e gjakut e kanë,

– ndërroje, shi do t'bjerrë  
e toka do t'kallet prej etjes...

Dhe kaluan mbretër,  
kaluan sulltanë, gjeneralë –

në bukën e kripën time  
pështynë e shkelën rëndë,

varre lanë pas;  
varre lanë pas

dhe  
shi.

Unë hodha një gur në hapësi.

## 5. (GJELIT TIM PENDLAT JU NDËRRUAN)

E ngreha pushkën e hakmarrjes.

Çka është liria – pyeta,

bjeshkët në gjunj ranë:

– Të vdesësh, të vdesësh, të vdesësh!

Dhe gjeli im kërceu tra e m'tra,

pendlat ju ndërruan një natë.

6. (PAS KOKËS SIME)

Para shtëpisë sime  
më keni vrarë –  
unë kam qeshur.

Në degën më të lartë  
të plepit tim  
më keni varur –

Unë kam qeshur.

Në gjinjtë e gruas sime lehonë  
pështyrë keni –  
unë vrarë kam atëherë

Dhe pas kokës sime

rënë kanë  
mbretër,  
sulltanë...



7. (GJERËSITË E JETËS I PËRFLAKU  
NGJYRA E PËRRALLAVE)

Shi atëbotë fryu  
një stuhi prej detit,

prej bjeshkës fryu e –  
bukurisë ja hoq duvakun

dhe gjerësitë e jetës  
i përflaku ngjyra e përrallave tona –

se – toka jonë orë e kohërave.

### III

#### 1. (BJESHKA DHE NJERIU)

Ngrihet e përgjakur gjer në re.  
Në maje të thikave  
qielli kotet.

Përanash klithin  
njerëzit e mbyllur  
në kafka vdekjeje,

bjeshka dhe qielli puthen –  
bjeshka  
dhe njeriu në litar.

## 2. (ERA FRYN)

Era fryn –

tokën e njeriut e zgjon,  
tokën e dashurive të mallëkuara  
e shkel rëndë.

Era fryn –

damarëve të natës vërshojnë lumenjtë  
e qielli resh borë,  
borëra të ftohta

në pikë të verës.

Përanash klithin  
njerëzit e mbyllur  
në kafka vdekjeje.

E era fryn  
kullën e dridh majë botës.

### 3. (UNË IK PREJ SHIUT)

Rrjedh Drini plak,  
Unë tretur kam shikimin tim  
në udhëtimin e tij të pafund.

Rrjedh Drini e –

përanash klithin  
njerëzit e mbyllur  
në kafka vdekjeje.

Rrjedh Drini e –

njeriu matet me bjeshkën,  
Ura të Shenjta  
hedh përtej kobeve –

dhe gjak rrjedh Drini plak e –

njeriu ushqen qëndresën  
dhe bjeshka luhartet  
në litare të vet.

Unë ik prej shiut.

#### 4. (TEHUT TË SHPATËS MARSHUAM)

Ja behën ushtritë e vdekjes –  
në pyllin tim të ujkut  
humbën pas gjahut.

Ja behën ushtritë e vdekjes –  
na u çelëm varret  
me eshtrat tanë,

tehut të shpatës marshuam.

5. (EMRI I GDHENDUR NË GURË)

Dikush prej nesh ndezi llampën n'kullë  
dhe s'u kthy më –

ne gdhendëm një emër në gurë.

## 6. (DITA E PARË, DITA E MBRAMË)

– Emri yt  
emër ujku,

– Shpirti yt  
shpirt deti,

– Ashti yt i jetës  
asht çeliku –

ndjeva varret  
rreth kokës

dhe shtatë konaqe  
vrapoi hija e tokës.

– Të falem Kosovë  
varr i dreqit,

çerdhe e lejlekut tim!

## IV

### 7. (MËNGJESI)

Me çka të të peshoj,  
me sy apo me zemër,  
me çka?

O, tërë botën  
kënga jote e zgjoi  
dhe kaltëria.

Me çka të të peshoj,  
me sy apo me zemër,  
me çka?

O, të gjitha dritaret e jetës  
krah e m'krah m'i çeli  
ëndrra jote.



## 2. (E PAKUFI JE SI SHPIRTI IM)

E pakufi je  
si shpirti im, e pakufi –

e unë pash e m'pash  
mundohem të të bi,

në grykë të shkëmbit  
të pi ujë bore,

në pishnaja t'malit  
të bëhem syri yt.

E pakufi je, e pakufi  
si shpirti im –

Kosovë, qetësi e dëshiruar.

### 3. (NË UDHËTIMIN TIM TË KAM ZBULUAR)

Sa herë kam vdekur  
në buzët e tua  
prej mallit –

ti betuar je  
në kokën time  
si në të djalit.

Sa herë sytë e mi  
ndezur janë  
me vravashkat e pikëllimit –

ti zë m'ke lëshuar n'valle  
e n'udhëtimin tim  
zbuluar t'kam

herë t'urtë herë t'harlisur.

#### 4. (DUA TË JEM)

Nganjëherë dua të jem lumë –  
të rrjedh nëpër damarët e tu,

nganjëherë dua të jem diçka e jotja  
bota jote të pushojë n'mua,

nganjëherë dua të jem ti –  
heshtjet e shirat e moteve t'i ndiej,

nganjëherë dua të jem etje –  
ujërat e tua deri n'pikë të t'i pi,

Kosovë – zjarr i përflakur n'damarë t'mi.

5. (EDHE...)

Edhe i mbrami plep  
nëse ka për t'u rrëzuar –  
unë do të dua.

Edhe e mbramja vatër  
nëse ka për t'u shuar –  
unë do të dua.

Edhe i mbrami burrë  
nëse ka për të mbetur  
në fushë mejdani –

unë do të dua.

6. (DRINI I BARDHË)

Nget Drini i Bardhë  
në rrafshinë të qetojë,

njerëzit të mbjellin  
bukën nën diell.

Nget Drini i Bardhë  
koha mos ta vjedhë.

Unë i falem rrjedhës së tij.

7. (NATA)

E lehtë dhe e butë  
si hapi im  
është nata në ty.

E dashur dhe e vrullshme  
si krahërori i gruas  
është nata në ty.

E qetë dhe e frikshme  
si shikimi i vajzës së dashuruar  
është nata në ty –

Kosovë, flamur i shpaluar në hava.

## 8. (LINDJA E MADHE)

Qe syrin e djathtë që të m'shohësh,  
kruan e shpirtit  
etjen ta shuash.

Qe dorën e çarë  
flamurin lart  
ta mbash.

Që diellin që ngamë  
në ballë për ta venë,  
pranverën e gjakut tonë.

Qe jeta e vdekja ime  
shtylla drite  
t'i kesh n'udhëtim.

9. (LUTJA IME)

Nëse vdes i dashuruar  
varrosmëni n'zemër t'ulkojës,  
biri i saj thonë jam.

Nëse vdes i urrejtur  
varrosmëni n'shkëmbin e nemur  
vdekje të reja kurrë mos t'lindë

gjaku im e i fisit.



## 10. (LUFTËTARI)

Pas shumë vjetësh durimi  
Vrava urrejtjen time  
që të jetoj i lirë nga vetvetja.

## V

### 1. (NË MES MEJE E KOSOVËS)

Në mes meje e Kosovës  
sa ura paska qenë rrëzuar!

## 2. (NË UDHËTIM EDHE NJË DASHURI)

Valë valë zdirgjet Drini i Bardhë,  
gjarpëron, ecën e gurgullon në mua. E – sa çudi  
njerëzit trupojnë, freskohen me ujin e tij  
pa e ditur se diçka kujtim i lanë kur të shkojnë

E – ti ende po më mat n’udhëtimin tonë  
ti që sytë i ngjeve në sytë e kësaj toke  
atë ditë kur të thashë: të dua, e dashur  
por s’di kë më shumë – ty apo Kosovën

### 3. (VOGLUSHI IM ME EMËR TË ÇUDITSHËM)

Voglushi im,  
gjaku  
të gjatë e ka dhëmbjen,  
gjaku  
t'thellë e ka varrin  
voglushi im.

Voglushi im,  
pa hile duaje këtë tokë,  
duaje më shumë se na  
që e deshtëm njëherë –  
duaje e mos mallëko fisin  
voglushi im,

Voglushi im,  
ec kah ecet –  
erërat keq mashtrojnë,  
vogëlushi im  
me emër  
të çuditshëm.

#### 4. (BETIMI)

Kam kuqluar shikimin e fundit t'ulkojës  
dyert e konakut  
krah e m'krah i kam hapur,

Kurr më s'do t'i mbylli!

Ndër këngë e vaje t'mia  
prore kam për të kënduar  
Kosovë – tokë e kuqe!

– Hej, nuk jam rritur  
për një ditë!

5. (EPILOGU OSE BISED  
E NJË POETI ME VETVETEN)

Në këtë çast çka mund të them për fisin tim?

A të them: ngritur kemi sarajet e mundit  
për zotërinjtë tanë

Vrarë jemi ndër veti për një shteg are,  
për një çikë

– na të harruarit nëpër shekuj e kohëra!

A të them: na në midis të pazarit qitur kemi pushkë

Sa herë kemi dashur të vdesim për emrin tonë.

A të them: na s'u ngjajmë aspak gjyshërve tanë...

Për fisin tim çka mund të them në këtë çast?

# TORZO

Rilindja, Prishtinë, 1971

*Në vend të luleve,  
prindërve të mi të ndjerë*

*Autori*





## MACA E ZEZË

në udhëtimin tim  
një mace e zezë më ndjek

e shpirti më thotë  
në gjysmë rruge ke për të mbetur

e kënga më thotë  
kurrë s'do t'm'këndosh me zë

e drita më thotë  
i verbëti i verbër ka mbetur

e ëndërra më thotë  
më kërkoi në zhgjendërr

por eja e thuaje atë fjalë  
kur s'di kë dashuron apo urren

eja e besoji fytyrës në pasqyrë

një macë e zezë më ndjek  
në udhëtimin tim

orën e fatit ajo dikton

## KOHA E GURIT

### ROZAFATI

secili i falëm nga diçka  
kush emrin  
kush eshtrat i la

nga gjaku  
nga zjarri  
koha sa herë eksplodoi

rreth diellit tonë  
sytë shpella i bëmë  
në bjeshkë s'pushuan tupanët

se secili i falëm nga diçka

armikut ja shtruam rrugën  
me kufoma  
deri te zemrat tona

e ai kurrë s'e shkeli  
perënditë tanë  
kurrë s'mund i arriti

se secili i falëm nga diçka  
kush emrin  
kush eshtrat i la

## KOHA E GURIT

te bedenet e tua  
mbretër e sulltanë  
ushtritë lanë

e kohërat sytë  
njëra tjetrës ja nxorën  
me eshtrat tona

te bedenet e tua  
emrat tanë  
ngriten në këmbë

e në kohën e karanfilave  
koha e gurit  
fillon

## BALADA PËR DHËMBIN E UJKUT

kushedi kush e ngriti  
e kujtim na la  
atë dhëmb ujku

prej rrapllimës së tij  
balli na luajti  
e kulmet  
e varret

prej rrapllimës së tij  
vallet tona i trilluam

e rrahën erërat  
e rrahën kohërat  
dhe ushtritë

nëmët tona larg u ndien

dhe s'patëm kohë të vdesim  
dhe s'patëm kohë të jetojmë

kushedi kush e ngriti  
e kujtim na la  
atë dhëmb ujku  
një ditë kur vraponim pas lumit të harlisur

një ditë për një ditë  
Kur veten humbëm  
e na gjetën të paemrit  
në gjumin e thellë të natës

## RRETH NESH E BOTËS

një det e një barkë  
pa kapitenë e detarë

një orë pa akrep e anë

në largësi një rrufe  
shumë zjarre në ne

dhe zoti dhe zoti  
me kamxhik e litar

fener i mallkuar në një det

## EMRAT TANË

herë nata  
i merr nëpër këmbë  
herë dita  
i kërkon me pishë

## SI TË KËNDOJMË KUR GJITHÇKA LIRUAM

kaluan kohërat si erdhën plot zhurmë  
t'pidentifikuar mbetëm sot e atë ditë unë e miku  
dhe këngët e moçme u harruan  
e si të këndojmë tani kur gjithçka prej frikës liruam



## KALI I TROJËS

### 1. (AI ËSHTË NË MES TË NJERËZVE)

ai është në mes të njerëzve

nga veriu nga lindja  
nga jugu nga perëndimi  
hyn e del si në shtëpi të vet  
në një guacë mallkimi

ai është në mes të njerëzve

## 2. (E TI S'I HARROVE ASNJËHERË)

këndeje e andej frangjive  
njerëzit duke të ndjekur veten harruan  
këndeje e andej frangjive ajrin ta helmuan  
e ti s'i harrove asnjëherë  
e ti s'i harrove asnjëherë  
çudia e zotit e njerëzit ajrin ta helmuan  
këndeje e andej frangjive

### 3. (PAS SHKUNDULLIMËS GJURMAT T'I FSHIJNË)

bien daullet në maje të botës dridhet Troja  
bien deri në çmendi e ti s'i ndien  
bien ditë e natë e ti ëndërron vjetët me acar  
ëndërron ndonjë tërmet të ri në botë bien

njerëzit të mbyllur në një kohë incognito  
shkruajnë historinë e vet me gjak e lak  
e gjurmat e tua fshijnë pas shkundullimës  
bien daullet pa pushuar e ti ik prej dritës

#### 4. (MË I RI MBETE SE ISHE)

ti je i vetmi kujtim nga antika  
që s'ke humbur kuptim as ngjyrë  
dhe prore je më i ri se ishe

je e vetmja kafkë  
që bën hije mbi Trojë

rreth botës sa herë u solle  
njerëzit të njohën  
prej hingëllimës  
prej trokut

e ti ndërrove qime ndërrove kohëra  
e më i ri mbete  
se ishe

## 5. (KTHEU NË VARGUN E HOMERIT)

ktheu në vargun e Homerit  
ktheu atje prej nga erdhe  
koha jote s'është kjo ktheu  
liroji njerëzit prej vetvetes  
e hijeve liroji prej maskave  
e ikjeve liroji prej pagjumësisë  
e heshtjeve liroji prej etheve  
e shirave koha jote s'është kjo  
ktheu në vargun e Homerit  
Troja ra e marsejezën  
kahmos s'e këndojnë njerëzit

## POEMA E HESHTJES

### 1. (EMRA KA HARRUAR)

kanë shkuar kanë ardhur  
kanë ardhur kanë shkuar  
njerëzit me pisha në duar  
në shpirtin e tyre  
heshtja shpirtin e vet ka kërkuar  
emra ka harruar

## 2. (NË NOFULLA TË NJË KOHE HESHTJEN PËRTYPIM)

s'di pse dhëmbët  
m'i le në lëkurën time  
kur më the se më do  
kur të thashë se të dua s'di pse

në mes nesh një mot  
kryet një gjarpër qiti  
shi në nofulla të një kohe  
heshtjen tani përtypim

### 3. (METAFORA E JETËS SIME)

nëse s'flas  
jeta ime s'ka qetësi

fjala ime bëhu unë

heshtja mos të shtypë  
në gurë  
mulliri

nëse s'flas  
jeta ime s'ka qetësi

fjala ime bëhu unë

plaga ime  
le të marrë  
frymë



#### 4. (ECI RRUGËS SIME AJO MË NDJEK PAS)

i flas më flet  
njëri tjetrin shkelim  
njëri tjetrit gishtat ja thejmë  
eci rrugës sime  
ajo më ndjek pas  
te një krua pritën ma zë  
ujin deri në pikë ma pi  
ja shkeli syrin një këngës së largët  
ajo ma grabit pa e kënduar  
ja zgjas dorën  
ajo s'e do e s'e do  
shpëtimin tim

## 5. (KUR DASHUROHEM NË FUQINË E RRUFESË)

kur dashurohem në fuqinë e rrufesë  
zotën pshurr në maje të Olimpët  
veshin e gurit shurdhon një kabanë mortore  
sytë një gjarpër m'i kërkon

kur dashurohem në fuqinë e rrufesë  
jeta gjithfarë formash merr  
shë bie mbi emrin tim  
dhe zogjtë harrojnë të kthehen në kohën tonë

## 6. (SI E HARRUAM NJERINË NË FUSHËN E BARDHË)

heshtja ka emër ka ngjyrën e vet  
damarëve të saj kush bredh pa pishë në dorë  
humb rrugën deri te emri i vet  
ajo ka kasaphanat bunarët  
ka spitalet çmendinat kumbonarët  
heshtja ka kohët dashuritë  
dhëmbjet ja zbulojnë syrin e saj t'fjetur  
kokën e madhe në fluturim zogjtë ja çokasin  
ditët vjetët në vesh i cicërojnë  
në barkun e saj kurrë s'mejnë

klyshët

derrat

ujqit

qe sa kohë një kavall dergjet në gojën e një sfinge  
heshtja ka shkallët e veta  
nëpër to zbritur kanë mbretërit gjeneralët e paemër  
nëpër to ngjitur janë kasnecët  
me këmbë të hekurta  
me kambë të drunjta  
ruajna zot prej sëmundjeve të saj trashëguese  
nga shurdhimi do të heqë shpirt një ditë  
heshtja s'është vetëm e kaluar  
s'është vetëm e ardhme  
në këtë fushë të bardhë njerinë vallë si e harruam

7. (SHIU DHJETË VJET  
S'PUSHON NË NJË LEGJENDË)

po e zëmë  
nëse e hudh një gur në lum  
heshtja ka temperaturë

po e zëmë  
nëse këndoj një këngë të moçme  
heshtjen pagjumësia e mundon

po e zëmë  
nëse veten e kërkoj në një lojë  
heshtja ka kokëdhëmbje

e shiu s'pushon dhjetë vjet në një legjendë

## 8. (SHTAT LËSHON NJË LULKUQ)

heshtja ime është më e vjetër  
se unë e më e fortë  
se vdekja ime

ajo është fytyra ime e dytë

heshtja kur flet  
numëroj yjtë  
luaj me hije luaj me thika

e në fushën e bardhë  
shtat lëshon  
një lulkuq

se heshtja ime  
ka peshën e gurit të malluar  
dhe gjuhën e njeriut të gozhduar në shkëmb

## 9. (NJË DITË)

një ditë heshtja  
ka për t'më gjuajtur  
me eshtra të mia  
ose do çmendem duke e rrënuar

10. (PAS RËNIES PAS NGADHNJIMIT)

lavdi djallit

lavdi zotit

## HIJA NË PASQYRË

### BALADA PËR NJERINË QË SHETIT LAKURIQ NËPËR BOTË

njoh një njeri  
i cili shetit lakuriq nëpër botë  
në vend të kravatës  
gjarpërin lidh në qafë  
në vend të këmishës  
lëkurën e ujkut vesh  
njoh një njeri  
i cili tërë kohën e lume  
zhvishet e zhvishet  
në një vend publik  
askush s'e këqyr me sy  
e ai shetit lakuriq nëpër botë  
si në kohën e egërsisë  
njoh një njeri  
i cili ka humbur gjithçka  
ndjenja  
sy



## LOJA E PAKRYER

*A. Pashkut*

vras m'vrasin  
askush s'varroset

pushkët e padukshme  
e koka ime në thumb

sillem sillen  
hudhem rrëzohen

askush s'fiton

kalon luani i çartur  
s'frigothem

vjen njeriu nga larg  
iki në skaj të botës

vras m'vrasin  
askush s'humb

vetēm shumohem  
shumohen

planeti bosh e kokat plot varre

## GJITHKUND PO MË NDJEK SHIU DHE HESHTJA

në këtë natë pëshpëritjesh ikjesh  
prej vetvetes botës  
ku vete kënga ime  
të dhashë shpirt ike qiejve  
të dhashë besim syrin ma shqeve  
të dhashë zemër më le pa kokë  
në këtë natë gjuetirash  
shqetësimesh  
dridhjesh shpirti  
kurvnie  
në këtë natë trimërie  
ku vete kënga ime  
në emër tim  
në emër tënd  
flet heshtja  
ku vete kënga ime  
në këtë natë asgjëje  
gjersa kishë gjuhë  
e bukur ishe shejtane  
medet gjithkund po më ndjek shiu dhe heshtja

## ZOTIT I LUTET E ZOTI E PËSHTYN

nëpër dritaren e verbuar të heshtjes së zgurdulluar  
një njeri i vdekur ëndërron të hyjë  
në kështjellën e lartë e të paprekur

ditë e natë ai rrëfen se si ka ngadhnjyer  
mbi padronë se si padrejtësi ka pështyrë

e jeta jonë njëmijë dritare i ka  
njëmijë veshë e njëmijë e një sy  
e një derë të rëndë pa çelës e dry

rrëfen e rrëfen ai i vdekur e kohën e vet kujton  
zotit i lutet ditë e natë në shëmti  
e zoti e pështyn në fytyrë zhlyer

nëpër dritaren e verbuar të heshtjes së zgurdulluar  
një njeri i vdekur ëndërron të hyjë  
në kështjellën e lartë e të paprekur

e unë në pikë të ditës sytë i mbylli  
e duart plot lytha i laj në shi

## MASKA

kush je ti që flet  
e fytyrën akoma s'ta pamë

sa të doni maska  
rreth meje e botës

maska që flasin  
maska që s'flasin  
maska që ecin  
maska që s'arrijnë askund  
maska që lindin  
maska që s'vdesin  
maska që tërë jetën mbesin  
veten pa e parë në pasqyrë

kush je ti që çon pluhur  
pas ëndrrës e ik

sa të doni maska  
rreth meje e botës

maska gjithfarë ngjyrash  
maska të panumërta  
maska që në kisha e xhamia

para zotit e djallit  
fytyrën ndërrojnë me të derrit  
e për një rrotë autoje  
Rozafat e Sokrat t'i shesin

maska që s'arrihen  
me dorë as shkallë  
maska që s'harrohen kurrë

sa të doni maska o njëqelizorë  
maska n'daçi për Olimp  
n'daçi për Babiloni  
vetëm guxim të keni dhe durim  
maska do të ketë edhe për krim

kush je ti që flet  
e fytyrën akoma s'ta pamë

## HIJA NË PASQYRË

gjersa pi një cigare  
fytjrën ndërron njëmijë e një herë  
ajo hije

e unë ja kërkoj kurrizin  
në tymin e cigares sime

flas bërtas vras  
sillem shtillem  
shqirrem

e prapë mashtrohem

oh pasqyrë e thyer  
me njëqind  
fytjra

## TORZO

### Ç'PO NDODH ME MUA

*Tim bije, Donikës*

unë kur këndoj  
jeta ime është pse

unë kur qaj  
jeta ime është pse

unë kur diç kërkoj  
jeta ime është pse

mbi vete kur dorën ngreh  
jeta ime prap' është pse

zot o djall  
ç'po ndodh me mua



## ME NJË TRËNDAFIL NË DORË

lart e poshtë bredh  
lule e pleh shkel e mbjell  
horizontalisht e vertikalisht  
vdes e lind si gazele si dhimbë  
me zotin jam me zotin s'jam  
në njëren dorë mbaj botën  
në tjetrën trëndafilin  
diell e gjarpër sillen  
rreth kokës sime  
lart e poshtë bredh  
me një trëndafil në dorë

## UNË ECI SHIU BIE

unë eci shiu bie  
jeta ik e ditët e vjetët  
s'sosen në një rreth

unë eci shiu bie  
në këtë dhe kurrkush s'e ndien  
kurrkush s'e sheh si bie në një legjendë

diku në botë një takim i harruar më pret

ku të strehohem  
n'katër anët lumi i vdekur m'kanoset e asnjë urë  
besën ja kam dhënë

në cilën derë të trokas  
as trupi im s'më pranon më  
e shiu bie

ashti im  
mos më verbo  
s'kam kohë të shërohem

unë eci shiu bie  
një këngë të zezë nata ma këndon  
jeta ik e ditët e vjetët

s'sosen në një rreth

prej kah ky dhëmb ujku në shpirtin tim

diku në botë një takim i harruar më pret  
e shiu curril bie në një legjendë

## ZOTIN PAHIRI E KRIJOVA NJËHERË

zoti im është i ri  
sa është i vjetër

ai di të gëzohet  
di të pikëllohet  
kur unë vdes kur unë lind

zoti im ka ngjyrat e veta  
ka ëndrrat e veta  
ka dëshirat e veta

ai di të dashurojë  
di të urrejë  
po s'di të vdesë  
se pahiri e krijova njëherë

zoti një ditë  
do të më humbë në udhëtimin e vet

TORZO

gjithkund kaloj e kurrkund s'jam

nëse më takoni ndonjëherë  
ju lutemi mos më lini pa emër

## NGJYRAT E HARRIMIT

kur pranvera vjen  
një gjarpër mbys në kullën time

këmbët gjak më pikojnë  
pas do erërave

kur pranvera vjen  
njerëzit në harrim më kërkojnë

## MA THUANI EMRIN

koha po më tëhuan prej hijeve  
lëkura ime si të të lëshoj  
pas kaqë vjetësh besnikërie  
lëkura ime si të kthehem në ty  
pas kaqë bredhjesh  
nëpër botën e zezë  
nëpër botën e bardhë  
koha kurtha të reja po kurdis  
miq të mi ma thuani emrin

**PËR DASHURI TË REJA  
JETA ËSHTË TEPËR E VJETËR**

VONË DO TË VDESE KJO STUHI NË BREDHJE

oxhaku i shtëpisë sime fluturoi,  
kali im,  
nga ike?

nata  
çdo herë ka mbyllur,  
në çdo konak ka hyrë.

si të shpëtoj prej këtij zjarri,  
kali im i verbër,  
nga më sjell?

sonte vonë do t'më çilet dera e konakut,  
vonë do të vdesë kjo stuhi  
në bredhje të marrë, e dashur.



## KURRË ATË EMËR

si të kanë quajtur para vdekjes, kurrë s'do ta dish.  
binarëve të jetës, duke rrëshqitur, s'do të matemi për emrin tonë  
me hijet e mesditës.

që tani jam njeri i përshëndetjeve,  
njeri i lindur prej vdekjeve  
e ti – shpuzë jete për atë emër.

kurrë s'do të dish si të kanë quajtur para vdekjes,  
o dëshirë e marrë, që kaq shumë dëshirove të jesh e huaj  
– kurrë atë emër!

## NATA E KUJTIMEVE

sonde të ëndërrova pas shumë vjet heshtjesh dyshimesh.  
nesër do ta shaloj kalin e kuq.  
deri te guaca jote e harruar në një det  
veten do ta ndjek pas si qen.  
sa rëndë po gërhet kjo natë e kujtimeve të zgjuara.

## TË KAM PASË THËNË NJË DITË

të kam pasë thënë një ditë  
kahdo që të nisem do të arrij te ti

të kam pasë thënë një ditë  
me ty një hap do ta bëj më larg

po sot e atë ditë veten humba  
e n'gjurmë askund s'të rashë

## EKSTAZA

vetëm dola, caqet e jetës flakandër janë  
si thirrjet e mia në këtë natë kurthash.  
muret kahmot u shurdhuan e sytë katërsh u bënë.

ti pse s'ma thua një fjalë  
po rri e më shikon si përplasem nëpër botë,  
pse s'ma thua një fjalë të urtë

që zemrën shëron, që selame të panjohura hap...

pëllumbat janë zogjtë më të lumtur,  
qiella për ta askund s'mbaron. Njerëzit dashurohen në ta  
edhe pse dikush i quan të marrë; dashurohen në fluturimin e tyre

të mbyllur në kaltëri: larg botës e kobit. po ty – si të quaj?

më është tekur emri yt si vdekja, o e paemër –  
as me zjarr s'po mundem të hedh jashtë kokës.  
në mua si lum gjaku ty po rrjedh. po ti – ku je?

gjërë e gjatë jam shtrirë në një livadh. pëllumbat –  
pse edhe na s'i kemi krahët e dashuritë e tyre,  
në kaltëri të ngjitemi njëherë: larg botës e kobit, o e paemër,  
pastaj të vdesim pas këngës, të vdesim në një det të hapët.

## DESHTA NJËHERË NJË DASHURI

deshta njëherë një dashuri  
emrin kur ja mësova një mot  
njerëzit ja përgjakën sytë  
dhe kot e zgjova një stuhi në det

PËR DASHURI TË REJA  
JETA ËSHTË TEPËR E VJETËR

fjalët e humbën fuqinë magjike  
për dashuri të reja  
jeta është tepër e vjetër  
kur kurrkush më s'mendon me kokë të vet

## NË PARALELEN IKS PËLCET NJË BOMBË

SHIU

hesht!

qan njeriu më i mirë e më i urtë,  
njeriu i tokës së djegur i tokës së vetëmuar  
– aqë i ëndërruar e aqë i dashur për botë e lule.

hesht,  
të lutem, o mëkatar,  
dhe hape zemrën!

shiu le të na rritë,  
shiu le të na sjellë qetësinë,  
shiu le të na dashurojë.



## NJERIU KU MBET

i flas kokës së dytë si vetes i flas  
në besimin më të madh buzë një deti i flas  
koka e tretë më përgjigjet n'gjuhën e hekurt  
puth buzën e kokës së katërt  
si buzën e dashurisë sime e puth flakshëm  
buza e kokës së pestë  
hajnisht puthjen ma kthen  
e bota si anije udhëton në spermë  
kap dorën e kokës së gjashtë  
si dorën e vëllaut tim të verbër  
dal e shetis para kullës në një livadh  
koka e dorës së shtatë më shtrëngon në fyt  
në shpirt një gjarpër ma lëshon  
shiu dhjetë vjet bie në një legjendë  
e shkrumin s'e lan  
ja kthej shpinën kokës së tetë  
maje një shpate zgërdhiet  
koka e nëntë  
dhe në paralelen iks pëlçet një bombë  
po njeriu ku mbet  
njeriu vallë  
atë që e lindëm  
atë që e vramë

## DUKE KËRKUAR NJERINË

thanë shkoi pas ngjyrave  
thanë shkoi pas fluturave  
thanë gjithçka thanë o zot  
dhe e pritën skaj horizontit

se thanë shkoi pas diellit

papandehur ja behën një mot  
arkeologët e kohërave moderne  
në një sy të madh shumë vjet gropuan  
për t'ja gjetur buzëqeshjen e humbur botës

## PËRRALLA

me shekuj pyetën ku është Olimpi  
më në fund e gjetën te këmbët e një përralle  
pastaj e kërkuan zotin me pishë e qiri  
pas shumë vjetësh  
në zot hetuan gjarpërin  
në gjarpër një ditë shpërtheu zjarri  
në zjarr gufoi lumi  
lumi vërshoi fushat e bukës  
urat fshatrat qytetet i muar  
ra mortaja  
ajo e ai po e zëmë  
më s'u takuan  
as te Ura e Fshenjtë  
as në Paris  
dhe prapë pyetën ku është Olimpi  
pastaj erdhi zoti  
gjarpëri  
zjarri  
lumi  
mortaja

dikush rrënzë kështjellës  
të gjitha këto i kish parë  
të gjitha këto i kish dëgjuar  
po asgjë s'kish besuar

# FOLJA

Rilindja, Prishtinë, 1973

*Hijeve të Çabratit*

*Autori*



KOKA E HUMBUR  
NË KROSIN AUTOMOBILISTIK

*Anton Pashkut*

koka  
rrota

rreth timonierit  
sillet bota

bota vërvitet  
jeta iket

n'shokdhome  
fiket

n'guaskë të një ëndrre  
dielli fle

në ne  
shi bie

pa ndërprerë

ditë e natë  
udha shkilet

sot as mot  
caku s'arrihet

po shiu  
gjurmët si nuk i fshiu

koka  
rrota

rreth timonierit  
sillet bota

pa ne



## PYLLI

### ËSHTË NJË PYLL

është një pyll

në atë pyll  
një dhëmb ujku

diku pas atij pylli e pas atij dhëmbi  
një sy miku

është një pyll

ku s'udhëtohet  
pa një yll

s'fillon kurrkund  
mbarimi s'i dihet askund

është një pyll

në atë pyll  
një lum

diku pas atij pylli e pas atij lumi  
fillon qielli

dhe një tokë  
pa anë e hënë

është një pyll

## BALADË MBI SOPATËN

u end njëherë nëpër mote të tymosura  
një sopat e ndryshkët thotë përralla e njeriut t'urtë

nga kodrat n'kodër nga kohërat n'kohë  
tehu i saj vetoi e sy verboi këndeje e andej kulle

ditë e natë fushave maleve u ra poshtë e lart  
bishtin e artë s'e gjet një sopatë e moçmuar

u end me vite me shekuj një sopat e ndryshkët  
ra n'zjarre e s'u dogj ra n'lum e s'u pa

luginës vajtën pas bishtit t'humbur n'pyll  
kodrës gjahtarët u kthyen n'kullë

thotë përralla e njeriut t'urtë harruar në një mur

## BALADË MBI BISHTIN

u end njëherë nëpër mote të zjarra  
një bisht i artë thotë përralla e djallit

u end e u çend e dhëmbët i dolën rrugëve t'gjata  
po dhëmbët e tradhëtuan se fshehtësi ish ajo fjalë

ku shkeli herri e pylli n'do ëndrra e hodh  
po s'fjeti se botën n'sy kish

rreth një rrashte e laku u mbështoll e u çmbështoll  
ai bisht e vrapin s'e ndali as pas varrës së shtatë

e fshehtësi ish ajo fjalë po dhëmbët e tradhëtuan

u end njëherë nëpër mote të zjarra  
një bisht i artë thotë përralla e djallit

një mot me shi humbi n'pyll pas një sopate t'thyer  
këndej as andej kulle më s'e panë  
as n'gjurmë s'i ranë

## ZJARRI

aty ku u takuan  
plasi zjarri

më kurrë s'u bashkuan  
aty ku u takuan

një sopatë  
e një bisht

KRONIKA TË  
KALORËSVE TË ZEZ

kishin dhëmbë  
s'kishin fulqi

kishin fyt  
s'kishin zë

kishin një sy  
i humbën të dy

NJË FYELL E NJË  
YLL NË NJË PYLL

në pyll  
një fy'll

në fy'll  
një yll

ylli digjet  
pylli s'digjet

## KASHË E LASHË

prej një koke del  
në një gabzherr humb

katalla është

në bjeshkë diellin fsheh  
në shtatë konaqe leh

n'qytetin e botës ënd'rojnë  
sytë t'ia therin

prej një gabzheri rrëshqet  
në një kokë mbyllet

katalla s'është



## NJERIU I BARDHË NJERIU I ZI

### NJERIU I BARDHË NJERIU I ZI

I.

në një tokë të zezë  
jetonte njëherë njeriu i zi

vallet këngët t'zeza i kish  
e zezë ish pjella e tij

jetonte njëherë njeriu i zi  
ënd'rronte ngjyrën e bardhë

botën n'grusht  
njerëzimin n'litar

buzë një deti t'zi  
jetonte njëherë njeriu i zi

një mot me shi  
shkeli njeriu i bardhë

n'tokën e tij t'pakufi

gjapërit ja shtypi kryet  
gjithshka mori ngjyrën mavi

gjurmëve t'njeriut t'bardhë  
u nis atëbotë njeriu i zi

një zot e di ku u ndal

II.

motet' in ndërruar

njeriu i bardhë  
e njeriu i zi

kështjellë ki'n ndërtuar

ai themelet  
e ai muret

ai kulmin  
e ai dritaret

ai oxhakun  
e ai dyert

motet 'in ndërruar  
e shpatat thyer

njeriu i bardhë  
e njeriu i zi

askund s'in takuar

ai ki' vajtur rrjedhës së lumit  
e ai i' kthyer burimit

### III.

te koka e njeriut t'bardhë buronte një krua  
sa çel e mshel sytë i humbte te këmbët

kalonin vite kalonin shekuj e një ditë  
qiste syrin n'shuplakë të tij t'çarë

njeriu i zi kodrës vinte kodrës kthente  
n'mbretëri t'vet armë farkonte

prej një shkëmbi buronte një krua

te syri i madh i njeriut t'bardhë  
sa herë zbriste njeriu i zi

rrugë ndërronte kohëra tjera zbulonte  
pas shtatë dritave gufonte

njeriu i bardhë ecte e ecte

ditë e natë në një pyll  
me një yll

IV.

rreth kokës përgjonte  
pylli

roje bënte ylli

koha ndërronte lak s'lëshonte  
njeriu i bardhë kodra lugina kalonte

diku  
pa pritur e kujtuar  
shkrepte pushka e njeriut t'zi

fikej ylli

rreth shpuzës sillej  
pylli

V.

njeriu i bardhë  
njolla t'kuqe  
la n'hapësirë

njeriu i zi  
fshiu  
detin piu

po 'i asht s'mund e përbiu

njeriu i bardhë pastaj  
vu zjarrin  
një kështjelle

duhi la në një dry

skaj një ure  
njeriu i zi  
pështyu

n'ngjyrën e kuqe  
humbi  
si mos t'kish le'

VI.

na ish ç'na ish

trup kish  
kokë s'kish

kish një fyell për mall  
një gjarpër të gjall'

me fytyrë shiu  
me fytyrë njeriu ish

na ish ç'na ish

kish një dhëmballë  
për një kalë të marrë

një fyt t'pafund  
zë as vesh për askund

shtatë luftëtarë e mpronin  
shtatë luftëtarë e ruanin



ditë e natë  
një përrallë të çalë

pas shumë endjesh

nga fyelli ku flente ylli  
një zog i bardhë fluturoi

botën me krahë mbuloi

gjarpëri hëngër veten n'pasqyrë

n'shishe t'djallit  
kopi ëndrrën një kalimtar

me eshtra e sy  
ngriti një kullë pastaj

shi i pasyri atëbotë tha  
po shoh

e s'ish zjarr as ujë ajo kohë

na ish  
ç'na ish

## KËNDEJ E ANDEJ SYRIT T'FYELLIT

### SËMUNDJA E FAMILJES SIME

*Tim et, Hamzë Podrimjes*

#### I.

babai im ndjesë pastë vdiq nga i thati në bark  
pa thënë fjalën e vet mbi dashurinë dhe njerinë  
nëna ime ndjesë pastë tri herë u bë operacion n'spital  
tri herë ujku uluroi rreth shtëpisë sonë  
vëllaut tim i plasi i thati në çmendi  
pranë një kroi hoq shpirt pa e parë kush  
motrën time e varrosëm tri metra thellë  
nën hijen e një plepi e varrosëm një mbrëmje vere  
me tërë qelbin e botës së f'llicur  
unë unë do të shkel planetin e mbytur n'ëndrra  
larg e më larg gjakut e flakës t'iki  
nëse nervat e mi në def t'kohërave shndërrohen  
oh sëmundje e familjes sime  
lojë e hatashme  
e fatit

## II.

s'e pa pushkën e babait tim  
n'kokën e tij fluturoi ai zog i zi  
dhe s'e pa pushkën e ngrehur

n'gjinj t'nënës sime zbriti pastaj  
dhe vëllau im i vogël vdiq pa lindur

kur bora e parë ra  
n'dritaren tonë vetëm zogu i zi fluturoi

po s'shkrepi rrufeja  
se vdekja e babës tim nga koka filloi

oh babai im i urtë  
luftëtar i botës

### III.

babai im ndjesë pastë  
tërë jetën botën shikoi  
përmes grykës së një fyelli

vdiste e lindte  
përmes asaj gryke

udhëtonte e udhëtonte

shkilte e shkilte mbretëri  
shkilte detra  
shkreti

babai im ndjesë pastë  
përmes grykës së një fyelli  
kthente në shtëpi

tërë jetën këndoi mbi vdekjen e një guri

babai im i urtë  
hero i botës

IV.

babai im ndjesë pastë shaloi ujkun

djali im vajti të mbyllë vrimën e miut n'kullë

## NË GJAH

në gjah dalim  
unë e kipci im

ai ikën territ  
unë dritën ngas

ai zbulon bukurinë  
në syrin tim thellë

unë fryej  
ashtit të tij

në gjah dalim  
unë e kipci im

ai gjuan rrashtën e vet  
unë fsheh detin ndër dhëmbë

ai ngre ura  
kokë e m'kokë

unë kaloj  
në mes skeleteve

e s'më shohin në botë

## TE ISHULLI LARG VETES E BOTËS

shtatë ditë e shtatë net  
udhëtova njëherë rreth rrashtës sime

ku shkela  
nga një asht timin gjeta

ku rashë  
fytyrën time pashë

te ishulli larg vetes e botës  
dhëmbët i theva

n'shënaum lexova poezi  
mbi syrin tim t'vdekur

nga ura e shenjtë kërceva  
kohën të kop n'grusht

shtatë ditë e shtatë net  
udhëtova njëherë rreth rrashtës sime

krejt mësova  
se ç'po ndodh me mua

këndeje e andej syrit t'fyellit

## KOKA E ARTË

### I.

na liro ose të robëruam

në karrigen e shenjtë  
koka e shenjtë  
diogjeni rreth dritës

na liro ose të robëruam

në barkun e planetit  
arkeologë t'panumërt  
thika në fyt

na liro ose të robëruam



II.

menduam se ar

zbrazësirë

zbuluam

## E FYELLI KËNDON PA I RËNË KUSH

KOHA IME

I.

koha ime ardhi

unë do të shkoj te mjeku  
që të shërohem  
nga sëmundjet e botës

koha ime ardhi

II.

unë kur rrjedh  
koha ime bjerr

n'gishta t'mi  
bie

po s'therret

zë thua  
në një asht

e n'syrin tim  
mbyllet

po s'mbytet

unë kur rrjedh  
vetveten vjell

n'pafundësi

## DHËMB I ZI

dhëmb i zi

njëqind herë i mall'kuar  
nën këtë yll

mbi trupin tim t'gjallë  
mbi trupin tim t'vdekur

ç'duhen betimet

apo sheh  
t'harruan stinët

nxëre nxëre veten nxëre  
larg kësaj koke t'helmuar

bota prapë po kthen  
në an të vet

dhëmb i zi

ETJET

kërkoi diell  
humbi qiell

kërkoi dashuri  
ndjeu uri

nga kafazi  
diellin ja liruan

nga lumi  
dashurinë ja sollën

ai kërkoi emër pastaj

para tij hodhën një gur  
shkruaje i thanë

pshurri në lumë

e gjarpërin  
s'e pa n'trëndafil

sytë e gozhduar  
n'qiellin e humbur

ja gjetën një verë  
gjersa shfaqej një magji

në teatrin e zi

## FLAKA E VJEDHUR

si e kafshoi gjarpëri?

e luanit i tha: hesht!

luani ra në gjunj para shpatës së tij.

një mot thanë: kahmos s'kemi parë

një shfaqje kaq të çuditshme n'cirkun tonë.

po vallë si e kafshoi gjarpëri?

në qytetin tonë tregojnë tani fëmijët

se ai shkoi të sjellë flakën

që një ditë me shi ja vodhën njerëzit.

e si e kafshoi gjarpëri?

luanit i tha: hesht!

e luani ra në gjunj para syrit të tij të thellë.

## E FYELLI KËNDON PA I RËNË KUSH

e s'u pa më

n'kafaz luani kërkon xhungël

bota sillet e sillet rreth timonierit  
e mbytet  
n'pjtë t'vet dy gisht thellë

thika heq valle

po ai s'u pa më

vijnë e shkojnë njerëzit  
një fjalë s'e thonë  
e fyelli këndon pa i rënë kush

palaço u hodh e u hodh n'hava  
vetëm njëherë  
ra

e s'u pa më



## LOJA E FATIT

desht të jetë zog  
në mes t'njerëzve t'kthejë pastaj përjetë  
desht në një kohë tjetër t'fluturojë  
e kurrë mos t'ëndërrojë

dhe e pamë fatit oh fatit  
me sy kur ja bëri ëndrrës  
e pamë  
t'veshur n't'bardhë

desht të jetë zog desht  
dhe kurrë dhe kurrë  
më  
s'ëndërroi

BUZËQESHJA

kur vdiq  
thanë lindi

dhe kafshët ndërruan padronin

# TRIUMFI

## ISHULLI I VDEKJES

si s'u gjet  
një çelës

si s'u gjet  
një frangji

si s'u gjet  
një varkë

mure mure mure  
dhe hapësi

## APOKALIPSA

në kullë thonë se më duan  
e koka ime shtizë e m'shtizë endet  
ai zog i kuq sa lart qiejeve po ngjitet  
e n'kullë thonë se më duan  
përtej shtizave nata n'katra ikën  
vaj nëse t'shkelin kalor'sit e mi

PA FOLJE

dhe prapë vetëm

nën këtë qiell  
mbi këtë planet t'zgiebosur

po ky litar  
rreth tokës

dhe prapë vetëm

larg botës  
afër vetes

diku nën këtë qiell  
diku mbi këtë planet

me gurin n'shuplakë

dhe prapë vetëm  
rreth flakës

## ËNDRRA DO T'MË ZGJOJË

*Rexhep Ismajlit*

më lerëni të flë

mbi kokën time  
mjaft folëm  
n'këtë kohë fytyrash

më lerëni të flë

ëndrra  
do t'më zgjojë  
n'shtratin tim

rojtare të hijeve t'mia

## NË ROJËN E VDEKJES

ku të doni më lini shok cezar

jeta ime është  
e s'është  
dhembje

çka s'mund të bëni  
gjahtar me nam jeni

gjersa të jem në roje t'vdekjes

mund t'veni n'gjah  
ose të çoni dashuri

bordel e m'bordel  
botën mund ta ndiqni

n'daçi me auto n'daçi me kalë

ku të donji më lini shok cezar

jeta ime s'është kohë e shkuar  
humb gjithkush  
kur unë s'luaj

## BUKUR ËSHTË

bukur është  
n'çdo qytet  
t'kesh nga një dashuri

se kushedi ç't'pret

bukur është  
pas çdo udhëtimi  
t'mbetësh ai që ke qenë

të bësh hije përtej mall'kimit

bukur është  
n'çdo qytet  
diçka t'harrosh

e prapë ta kërkosh  
në jetë  
bukur është



## TRIUMFI

qeni t'zonë le ta kërkojë nëpër botë  
dhëmbit tim po i kthehem

më mirë gur  
se urë

qeni t'zonë le ta kërkojë nëpër botë  
n'plagë t'vet dhëmbi lulon

më mirë mur  
se udhë e harruar

vaj kulla ime  
me kokën time ndër duar

## REBELIMI

rrugës së njeriut t'urtë do të vete  
gjersa të bjerë shi mbi mua dhe flakën e tokës  
nën thembrën e polifemit  
për të zbuluar fshehtësinë dhe arin e botës

do të vete

se ai që këndon vetëm mbi syrin ashik  
se ai që pispilloset në majë të olimpit  
ai hoq dorë kahmos nga unë  
rrugës së njeriut t'urtë do të vete

tërë duke pshurrur fotografinë e botës

## KREDO

qeni leh  
kur i bien dhëmbët

dhe thonë atëherë  
se dreserët kohët e vështira i kujtojnë

## EMRAT E SHKIMBUR

### BIBLA

ditën e parë  
zoti krijoi rrotën  
pastaj njeriut ja theu kokën  
ditën e dytë  
zoti krijoi karrigën pastaj hirrën  
ditën e tretë  
zoti krijoi gozhdën pastaj qiellën  
dhe një gomar na e solli në jetë  
ditën e katërt  
zoti krijoi gjakun pastaj mykun  
ditën e pestë  
zoti krijoi ëndrrën pastaj shinë  
ditën e gjashtë  
zoti tha  
vrit se t'vranë  
ditën e shtatë  
zotin e shkelën djajtë  
nata ra mbi botë  
nata u ndry në kokë

## KARRIGIA

gëzimit katër këmbë ia mbaruan

fjalën e mbështollën me ar  
në një kohë t'vdekur e varruan

një ditë prej ditësh  
karriga lindi karrigën  
karriga gëlltiti karrigën

po gjahtarët e ëndrrave  
fshehtësinë zbuluan

nga mali i gjarpërit  
sollën drurin e lartë  
në të do të ulet gëzimi thanë

e pikëllimit katër këmbë ia farkuan

zoti im zoti im  
si botën rrokullis  
tatpjetë golgotës

ajo çudi pa asnjë sy

## BALADË BLERAKE

kush e la në tryezë  
këndej frangjive askush s'e pa

lacrën që vodhi blerimin  
që mori frymë një verë

ja botën tani shikon  
shtatë bjeshkë larg dëgjon

vesh as sy s'ka

kush e la në tryezë  
andej frangjive askush s'e pa

lacrën që desht të jetë lumë  
që desht të jetë zjarr

n'syrin e gastartë të jetës

## SPIRALJA

bëri çka s'bëri  
sytë s'i therri

preku  
ngriu

ndërroi  
ndriçoi

piu  
përbiu

nga kati i nëntë ra  
në të tetëmbëdhjetin kërceu

eja e zbritë në tokë

çfarë spiraleje  
në mes njeriut dhe djallit

## EMRAT E SHKIMBUR

maskat ranë

heronjtë ku vanë



## NJË BUKURI E PAPANË

s'ishte e kurrkujt  
se e gjithkujt ishte

një bukuri e papapë

## NJERIU ME PLAGË NË KOKË

### NJERIU ME PLAGË NË KOKË

ka ditë ka vite ka shekuj  
që njeriu me plagë në kokë  
qëndron mbi tavolinën e bardhë të spitalit

unë shter lumenj liqej dete  
të arrij në fillimin e plagës  
kapërcej kobe zjarre kohëra  
thonë se fundi i gjendet pas horizontit  
ndal hovin e rrufesë  
n'shuplakën time  
mushkëria e sëmurë të marrë frymë  
liroj zogun e kuq nga plaga e tij  
nxjerr thika  
gjarpërinj  
errësira

ka ditë ka vite ka shekuj  
që njeriu me plagë në kokë  
qëndron mbi tavolinën e bardhë të spitalit  
ajo plagë aqë e thellë  
sa çdo gjë humb  
nën hijen e saj

# **CREDO**

Rilindja, Prishtinë, 1976



## FISHKËLLON E KAFSHON

### E GURI IM RROKULLISET

a ka për të më pranuar gjaku im  
apo duhet braktisur në botë këpurdhash kthyer

bien mbretëritë një pas një  
e guri im rrokulliset në pakufi

boshtësisë fishkëllon fishkëllon e kafshon  
njeri apo mi më qëllon

a ka për të më pranuar gjaku im  
apo duhet braktisur në botë këpurdhash kthyer

## BARDHË

### ISHULLI

humbja të zbulojë  
fshehtësi e madhe

heq e le tani në valë  
halë e gjallë në zall

ç'po të rrahin detrat  
durimi ç'po të rrit

kep i tretur në re  
rrenjë e thellë në gorre

ditë e natë varka shket  
kah ti tokë e gjakimit

e të zdeshe e të vesh  
kaltaria e mbytur në sy

## VALORE

Njeriu shkund cigaren

na ofron Bregun  
Varkën na ofron Shpatën

po të kujt këta thonj

luanin tërheq për hunde  
një mace e zezë

nëpër Valë e Fjalë  
E bukura shplon fytyrën

po të kujt këta thonj

në majë të gjuhës  
Bota rrëshqet e nerva ngreh

më në fund shterpësia grua që pjell  
në çdo stinë e kohë

Njeriu ndez cigaren  
nga thonjtë s' duket Bregu

## BARDHË

syri zi bardhë mos qoftë rrënë

bardhë dhe Bregu përrallor  
bardhë dhe gruaja në breg

krejt bardhë dhe e paprekur

syri zi bardhë mos qoftë rrënë

rrufeja vizaton dashurinë  
vizaton vdekjen me zjarr-hi

në mes dy tehave Njeriu kokën luan  
lartësive gjuhen perënditë

në një guaskë tërmete e tërmete  
pastaj bardhë bardhë bardhë

dhe qe nga Bardhësia vetveten s'e shoh  
as bregun as gruan as varkën në valë

syri zi bardhë mos qoftë rrenë



## E SYRI TË ZMADHOHET

### CUNG I VETËM NË PYLL

I.

cung i vetëm në pyll

a të zgjon era e jugut  
mbi kokën tënde a fluturon zogu

ta la qielli  
dheu e blerimi

në mes djeshmes e së nesërmes  
formë ndërron

cung i vetëm në pyll

a i ndien vitet mordjen  
ujin e zi në rrënjë

rri varr në kaltri  
e syri të zmadhohet

cung i vetëm në pyll

II.

shtatë katunde shëronin  
sëmundjet ëndrrat me rrënjën tënde

shtatë bjeshkë lidhnin  
Fatin për majët e tua

më i riu më plaku ishe  
në kohëra tua të qena e të paqena

dergjej Gjergj Elez Alia sa vjet

e koka të reja mbinin  
sa herë ngjiteshim te ti

qe edhe hija jote e lashtë  
shpinën ta ktheu n' thikë farkohet

në një mbretëri

dru i lartë dhe i bukur  
cung i vetëm në pyll



IV.

sëmundja jote  
ngjyrë e bardhë

Njeriu vrapon e vrapon  
me ditë vite shekuj

nga Ajo të dalë  
po flaka jote

valë harrestare

rrufe hiena mbi Botë  
tërë jetën gjuan

dhe papandehur njëherë  
kokën e vet rrokullis

sëmundja jote  
Jug i harruar

cung i vetëm në pyll

V.

rënia  
s'është  
humbje

humbje  
s'është  
me ra

s'është

cung  
i vetëm  
në pyll

VI.

ka kohë që udhëtojmë për të parë  
në botën e Njëmijë e një çudirave

prej kokës sate të madhe e të bardhë  
ka kohë që s'e shohim Pyllin

cung i vetmuar që faron vetveten  
në besimin tonë për të vdekur i bukur

qe në Mit shndërrohesh në Magji  
të mos prek Dorë as Orë

## NË NJË PLANET TJETËR BIE TI

GURI

I.

çdo gjë është e përkryer në ty  
dhe askujt s'i falem  
sa forcës sate

ti kërkon Hapësi vazhdimisht kërkon Hapësi  
dhe unë të lëshoj vend hapa ndërroj  
pas çdo pushtimit tënd

pesha jote më tërheq kah Toka – drejtpeshimi  
larg halave-e – valëve-e-fjalëve  
që kryet ma kërkojnë

unë saherë lëviz dorën  
në një planet tjetër bie ti  
dhe pa frikë hy në jetë e sillem në Rreth

në ty çdo gjë është e pathënë  
kaq e thëna nëpër hënë  
gur që fishkëllon-ndriçon cektirave-thellësive

bie në gjunj para teje  
dhe lutem për forcën tënde  
që Botën mban në shuplakë

2

re te unë  
dhe Unë durimin ta fala

gjymtyrët e mia  
janë trajtat e tua të derdhura nëpër Histori

re te Unë  
po a do të ngrehë kullë prej teje Urë

ernave në mejdan  
a do t'u dal a do t'i turpëroj

prezenti im a do të jesh ti  
apo tkurrja ime do të më zbraz nga gjithçka e jotja

re te Unë  
dhe Unë heshtjen e mësova të flasë

ja Promethe  
zjarrin ta kthejnë kopilat



ve veshin në botën tënde të çuditshme  
raste epike  
në Erën e kozmetikës

ve veshin dhe dëgjoj kujisen e bravave ernave të vdekura  
shirat e verdha  
vërshimat

pastaj nxjerr Shpatën nga klefti i kohërave  
Formën tënde më të re  
fitoj

shaloj at e shaloj shpat

në lindje në perëndim  
vida e vida  
o At

ve veshin

po assesi të mësoj Fshehtësinë  
se ku se ku gjithë ai durim në ty  
guri im

II.

hudh gurin në hapësi  
Sizifi plak me mund

prapë e hudh dhe e hudh  
valë e më valë e i gjallë

pres me ditë e tres përditë  
hapësi e hapësi kërkon

rrënjë lëshon në mundësi  
në pamundësi erna tremb

hudh gurin në hapësi  
hapësi çpon e çpon

kohëra e kohëra përgjak  
dhe mund Sizifin plak

2

ç'gurron guri në gurinë  
gur guri ndër gurë më i gurti

gur i gurëzur pranë gurit  
gurth i nguruar rreth gurit

gurron guri në gurë gurësh  
guro guroje gurin në gurinë

ç'guri pranë gurit gur guri  
birë e parë e fyellit tim

3

nga ëndrrat e ujërat  
hapësinën ta ruaj

nëpër duar më humb  
nën këmbë më rrëshqet

më bart e më bart një breshkë  
e në udhëkryq më le

ashtin ta fal  
syrin tim të madh

thonjtë m'i le në fytyrë  
shpirtin ma shprish

dhe prapë kokën time  
mbjell për Farë

4

merreni këtë guri e hidheni  
ku të doni nëse dëshironi

përtej fillit tim e fisit  
përtej 9 plagëve të Gjergj Elez Alisë

në mes ëndrrës e zhgëndrrës  
gozhdoni po deshtet Muroni

merreni këtë guri

pagëzoni ose lerëni pa emër  
ndërrojani kohën ndërrojani klimën

lerëni pa tokë lerëni pa qiell

merreni këtë guri e hidheni  
ku të doni

fortësia e tij na përjetëson

## DROJA

vajta në gjah

gjuajta e gjuajta  
etje e etje shuajta

murova një ëndërr  
mbretëri e mbretëri mbretërova

vajta në gjah

lashë asht lashë lëkurë  
vura një guri në kullë

në kullë mbylla  
një yll

ruajna zot  
nëse guri më tradhëton

## LOJA E DRITAVE

guri luan e luan  
as mur  
as unur

në lojë dritash  
ç'shkelqim  
dhëmbësh

E PA-NJOHURA

ç'zog i bukur  
po gjahtari i verbët dhe i pagojë



## SE ÇDO GJË NDIHET ÇDO GJË SHIHET

KULLA

I.

deri te Kulla ime  
udha e pa-njohur më çon

hap derën mbyll peisazhin  
lëshoi grilat ngjyrë gri rreth meje

nën kokë  
ve Çelsin dhe Shpatën

dikund në mes meje e botës  
tufa kullot ëndrrat

II.

në asnjë arkë Fshehtësia

nëpër muret e humbura  
hija ime më kërkon

ditë e natë natë e ditë  
hija ime shetit pa mua

e në asnjë arkë Fshehtësia

balli im ngritet e ngritet  
tufën mbulon në një Pyll

dikund në mes meje e botës

III.

ndez llampën

po ç'ka guri im  
që nuk ze vend

lëviz e lëviz  
tokë as qiell s'e pranon

e një mbretëri  
ndjek një mizë

po guri im ç'ka  
që rri pezull mbi botë

IV.

tash duket tash s'duket

hije s'është hije bën

mbështillet s'lidhet

rrjedh s'është lumë  
brigje merr Botën ve n'gjumë

ç'shtillet s'zgjidhet

në të zon leh natë e ditë  
vetveten s'e njeh sot as mot

qetësi kërkon shqetësim le

tash duket tash s'duket

dikund në mes meje e botës  
Kullën ma ruan

V.

përditë e më shumë  
përditë e më pak

në Kullën time  
hy e dal dal e hy

pa Çelës pa Shpatë

se çdo gjë shihet  
çdo gjë ndihet

e deri te ajo  
udha e pa-njohur më çon

## ËNDRRA QË VAZHDON

### ËNDRRA QË VAZHDON

hekurishte hekurishte hekurishte  
Njeriu tash në kokë tash në rrotë

dikund në një Spital Bota aborton  
kopili heq shpirt në mes kopilave

ve buzën në buzë të sfigës  
zjarri zgjon ëndrrën që vazhdon

në mbarim të një aventure të marrë  
Njeriu mbyllet në andrallë

ç'fshehtësi në mes dhëmbëve  
e Bota nëpër shnjestër përbihet

mbi kokën time zogun e yllzuar  
përgjak shtiza e rrezeve radioaktive

hekurishte hekurishte hekurishte  
Bota në vrap Njeriu në trap

## MASHTRIMI

shënon mollën në degë  
e pamundur ta këputish

shkëlqimi i saj të lëbyer

nga varrë e thellë  
arin e botës derdh

molla formë s'ndërron

në gur të fatit shkel  
mollën në degë qëllon

gërdheja të mbet në fyt

## HAPËSIA

gjithnjë e më shumë ndjej të rënat e hapësisë në brinj

kaq shumë mullinj rrokaqiej përçues  
fshatra qytete shtete  
kaq shumë spitale në botë për një natë për një ditë  
imzot

djathtas majtas  
më sulmon vazhdimisht më shtyp  
shpërngulje prapë nga lart posht nëpër vapë ngricë

përbihet në mua e nëpër mua majët e shemb  
jasht meje e kohës  
pëlhura ngjyrash end

pa frymë do të mbes

në brinj ndjej të rënat e hapësisë gjithnjë e më shumë

Bregut i afrohem  
apo E pa-njohura  
më pushton



## DYSHIMI

nuk besoj në gurin  
që s'heq më rëndë se të zit e thonit

as në atë që thuhet hapët  
të kem në zemër rrena më e madhe është

pagjumësia s'lypset shëruar  
bota zgjuat jeton edhe kur ëndrron

nuk i besoj zogut që fluturon lart  
i besoj asaj që dora ime e arrin

syri i gjahtarit të mirë  
dallon fluturimin në të parë

nuk besoj në atë që zbrazet  
se ka për t'u mbushur ndonjëherë

dashuria ime oh dashuria ime  
athua ti udhën ma tregon

## MORTALE

në një Cirk  
zdeshi vetveten  
gjersa asht i gjallë mbet

në gërshër vu Gjuhën pastaj  
nga fyt i tij i errët  
rrodhën lumenj detra oqeane

e përtej Gurit e Murit hiri i tij

se zbraktësia e pafund e pafund  
e pafund  
krisht i rinuar

## E PAKRYERA

vdekja kapërceu vetveten

ballin e ëndrrës sapo e preku  
hoq shpirt

jeta e palindur krejt  
art i lirë

## DËFTORE

### DËFTORE

kushedi prej kah kish ardhur prej cilës kohë kish  
pikur i panjohuri  
me një kokë në shpatë  
e me një sy qorr  
vorr

si mund të jetohet këtu Kish pas pyetur  
po si jo Madhëri K'in thënë Ata  
po guri  
unur K'in shtuar Ata me brincë në duar

dhe guri sa çel e mshel sytë ish çarë nga një rrënjë  
e padukshme

shtatë dryra shtatë net e shtatë ditë s'in çelur as  
mbyllur në Kullë

po uji kah rrjedh uji  
uji Madhëri K'in qeshur Ata po uji rrit këtë guri  
mbi kokën mur

i panjohuri konak e më konak ish endur  
me një kokë në shpatë  
e me një sy qorr  
vorr

një natë me shi kish pas pyetur pastaj për zjarr

s'dimë ç'është zjarri K'in thënë Ata

dhe kish vetuar në male  
kish djegur  
në fusha

kushedi prej kah prej cilit det kish fryrë një stuhi  
atëherë  
shi kish rënë e toka çarë prej thatësisë  
copë e grimë bërë qielli prej shpatave prej thundrave  
e shi kish rënë ditë e natë

të panjohurin thonë se juga e kish kapërdirë  
thonë se veriu gjurmët ia kish fëshirë

një mot me pjallmë ia kish behur një udhëtar i çalë  
me një gomar

prej çfarë sëmundjesh vuajnë  
çfarë emra u ngjeshin fëmijëve kafshëve  
kish pas pyetur gjithçka kish pas pyetur o zot

në një kohë të pakohë Ata i k'in treguar malet

atje ka gjarpërinj Kish pas thënë udhëtari  
ka Madhëri po nuk na hanë K'in thënë Ata  
po ç'bëni atje lart Kish pas pyetur pastaj udhëtari  
rrimë me zogj rrimë me ujë K'in thënë Ata

e te pragu i Kullës kish plasur gomari nga marazi

udhëtarin e çuditshëm  
e k'in kërkuar në male e k'in kërkuar në fusha  
sot as mot s'e k'in gjetur  
as zjarri s'ish shuar ndër prita

pastaj kish ardhur sulltani  
oh vdekje si të mban Kulla brendë  
sulltani kish shkuar kish ardhur krali  
krali kish shkuar kish ardhur i biri i sulltanit

kalit i k'in dhënë emër e dritën e syrit harruar medet

kohët prapë 'in ndërruar në gurë e plakur në mur  
dhe dritaret 'in mbyllur  
e hapur  
në një përrallë

një ditë për një ditë  
Ata s'in ngjitur në male s'k'in rënë në fusha  
në sy qiellin e k'in fshehur  
dheun ndër dhëmbë

pas shumë e shumë vitesh kish pas ardhur një tregtar  
gjithçka kish pas shitur e blerë ai i giorë i padorë  
kish pas pyetur pastaj për iks sëmundje për ëndërra emra  
ata k'in qeshur k'in luajtur rrotën e motmotit'

dhe prapë tërmete k'in ndodhur  
e mullinjtë  
bluar

k'in kaluar ditë k'in kaluar vite k'in kaluar shekuj e  
një Verë  
një Djalosh me fyell peshë kish çuar Gjakun  
peshë kish çuar Valën

Brigje në dorë ju paça



# TRAUMATIKA E BOTËS DHE TJETËRSIMI I SAJ\*

## 1. Përkujtim

Çka mund të themi sot për *Torzon* e Ali Podrimjes, sot, thua ja mbas një distance kohore prej dhjetë vjetësh, mbas asaj distance, e cila sikur këtë libër e ka bërë *fakt letrar*, jo vetëm në kuadër të poezisë së autorit po edhe në kuadër të poezisë sonë. Është kënaqësi e veçantë kur dikujt i bie ta paraqesë një vepër me rastin e ndonjë ribotimi, sepse e di se ajo vepër ka siguruar një prani të opinionet e ndryshme, qofshin ato amatore apo profesionaliste, e sidomos atëherë kur mendon se është bërë fakt i pakapërcyeshëm në rrjedhën e ndonjë procesi letrar e intelektual. Edhe vetë, duke u interesuar për këto probleme, *Torzon* e kam konsideruar si fakt të rëndësishëm letrar. Ndoshta këto pak refleksione janë të ngjyrosura me pak ndjenjë të momentit të shkrimit, po ç'të bëjmë, kam të drejtë në këtë të vërtetë timen, po fundi i fundit, e vërteta duhet të afirmohet që të bëhet e vërtetë e përgjithshme, apo ndoshta është e vërtetë se e vërteta ekziston në forma të ndryshme dhe, varet prej nesh, prej vullnetit tonë të drejtë dhe prej guximit që ta afirmojmë e ta themi atë, sepse, përndryshe mbetet e vërtetë e vdekur... e ky libër insiston në një të vërtetë, që mund të themi se është e tij, e vërtetë e vërtetësisë artistike.

---

\* Psthënia e botimit të dytë të vëllimit “Torzo”, botuar nga “Rilindja”, më 1979. Titulli është i redaksisë së këtij botimi.

## 2. Standardizimi poetik

Është e dhënë e bindshme se më këtë libër Ali Podrimja e arrin standardizimin e poezisë së tij, do të thotë të tekstit të tij poetik. Me këtë term dhe me këtë konstatim kuptojmë se poezia e tij merr formën e një stabiliteti dhe nivelizimi në vetë strukturën e poezisë dhe në kuptimin e saj. Kjo, pos të tjerash, do të thotë se i gjithë libri i poezisë përbën një nivel të përbashkët, ku çdo varg dhe çdo poezi është krijuar në atë mënyrë që të qëndrojë në pavarësi të tërësisë, e vazhdimisht në kuadër të tërësisë. Pra këtu kemi të bëjmë me tendencën që çdo poezi e librit të jetë poezi *në vetë*, një mikrobotë që ekziston dhe flet vetë. Ndërsa në kuadër të librit nuk mbetet tjetër pos t'i kërkojmë relacionet midis poezive, që përbëjnë tërësinë e përgjithshme të tij. Ky koncepton i realizuar në këtë libër na përkujton marrëdhëniet dhe ndërmarrëdhëniet e atyre si i jep Étienne Souriau, i cili prozodinë e pastër, poezinë dhe letërsinë e merr si arte të paartikuluara, çfarë thotë se ato përmbajnë nga diçka nga të gjitha llojet e arteve. Në vijim të eksplikimit të këtij konceptoni, do të shtonim se formësimi poetik i librit *Torço*, thuajse më shumë i përket fushës së arteve të *Volumenit*: skulpturës dhe arkitekturës. Më tutje: thuajse çdo poezi del nga një *koncepton skulptural*, që ajo, me pavarësinë e vet, si vetë figura skulpturale të qëndrojë në hapësirën e kuptimit. Këtë koncepton duhet ta kuptojmë jo vetëm në planin fizik të ekzistimit të figurës, por, në këtë poezi, edhe si kuptim të plotë, pra në qarkun e botës së tij filozofike.

Këtë këndshikim na e imponon titulli i *Torços*, i cili në planin e strukturës së tekstit poetik përmban një botëkuptim të tillë që e thamë më sipër, e në planin semantik, të kuptimit të tij, do të gjejmë elemente kapitale, që e mbajnë të gjallë dhe e fuqizojnë atë botëkuptim.

### 3. Torzoja dhe torzioni

Semantika e figurës *torzo*, etimologjikisht dhe realisht na sjell te kuptimi burimor se ajo është figurë njerëzore e dëmtuar, e gjymtuar, e cunguar, fundja e deformuar, baras me shëmtinë. Dhe kjo torzo ngritet nga procesi *i torzionit*, i deformimit maksimal të figurës njerëzore. Pra, përmes torzionit fitojmë atë torzon gjithëherë të pranishme si e mbetur e artit njerëzor.

E semantika e torzos që ngritet nga kjo poezi realizohet në konceptin poetik – të jipet fotografia e njeriut dhe e botës që, *de facto*, është torzo, gjymtësi, sepse po ashtu është një figurë, një imazh që “*noton*” nëpër kohë e hapësirë. Poeti e percepton mjaft qartë artistikisht këtë figurë si një *perpetuum mobile*,

*gjithkund jam e kurrkund s'jam*

*në ndonjë kohë po më takuat ndonjëherë  
ju lutem mos më lerëni pa e emër*

(Torzo)

Ideja qendrore e torzos materializohet nga torzioni i botës dhe njeriut, të dhënë përmes një gjuhe të fortë, kundërvënëse, e jo drejtpërdrejt që do të jepte ekzaltimin. Përkundrazi këtu ndeshemi me *brençën*, e cila për t'u realizuar, përdor të vetmen mundësi të artit, ironinë e skajshme të ngritur nga revolti i njeriut të revoltuar, i cili ndien neveri të pakufishme ndaj botës së torzionuar. Ky negativum poetik është afirmim i tërthortë i pozitivumit të njeriut dhe të botës. Kështu në relacionin njeriu-bota, që është një ndër më të rëndësishmit në gjithë poezinë e këtij poeti, e që fillon nga *Torzoja*, realizohet qëllimi i tij që të kërkohen elementet qenësore të qenies njerëzore në dy fusha ku ajo ekziston: njeriu si ide, si mundësi dhe njeriu si realizim, si produkt shoqëror e njerëzor. Duke dhënë diagnozën e njeriut të realizuar, përmes një analize mjaft të fuqishme poetike, në mënyrë fare të qartë dhe bindëse del ideja mbi njeriun, si kërkesë e natyrshme që ajo ide e tij të realizohet drejt e plotënisht. Pra ideja e tij mbi njeriun dhe

fushën e qeniesimit të tij, botës, është *bregë për mosrealizim*, e që këtë mosrealizim e sinjalizon përmes shkatërrimit, fundosjes, ironike të elementeve ekzistuese. Përndryshe, duke e nxjerr këtë relacion, në gjendjen ekzistuese, si alogjik, pra duke e vënë në parimet e alogjikes, poeti konstituon një ironi të fortë e shkatërruese.

Ja edhe një shpjegim tjetër. Etimologjikisht fjala *botë* korrespondon me shoqërinë, me bashkësinë njerëzore është një qenësi, realizimin e së cilës e bart qenia njerëzore. Në këtë poezi, kjo merr kuptimin shenjzues-simbolik dhe shpesh del si objekt-simbol. Kështu bota si hapësirë kohore-sociale e ekzistimit shpirtëror lidhet ngushtë me faktorin që e krijon kuptimin e saj, me njeriun. Pra, semantikisht, bota është fushë e realizimit të njeriut dhe, njëkohësisht rezultat i relacioneve njerëzore. E kështu duket semantika sociale-etike e botës. Pos kësaj, në poezinë e Podrimjes mund të nxjerrim një regjistër tjetër të botës-njeriut, që është më i degëzuar. Regjistri semantik i poezisë së Podrimjes mbi botën është ky: bota me sëmundje si fenomen, me dhembje, e ndotur, bota me Kalin e Trojës, me maca të zeza, me Perëndi të tipeve të ndryshme, etj. Përfundimi: bota si produkt i njeriut, si shenjë e raporteve njerëzore nuk korrespondon me vlerën e saj, me shenjën që i duhet dhe që i përket. Është shenjë e pavlerë. Fotografia e botës te *Torzoja* është: negative, imazh me mesazh negativ si konstatim, e kur dihet se çdo konstatim i drejtë jep diagnozën e mirë dhe zgjidhje pozitive, atëherë na inkurajon.

Dhe narratori poetik ëndërron e sheh se si, nga gjithë ky *negativum*, arkeologët e kohërave moderne kërkojnë buzëqeshjen e humbur të botës. Pastaj një përkujtim:

*njoh një njeri  
lakuria shëtit nëpër botë*

*në vend të kravatës  
gjarpërin lidh për qafë*

## (BALADË PËR NJERINË)

Përmes zëvendësimit opozicional të *kravatës* me *gjarpërin*, mjaft i qëlluar, që del nga një analogji metaforike poetike, poeti jep një ndër figurat më të thelluara ironike-tragjike, e cila mund të hyjë, lirisht, ndër shembujt më të realizuar jo vetëm të poezisë shqipe, po edhe të poezisë bashkëkohës në përgjithësi. Them kështu, sepse kjo figurë poetike është kuinstencë (qenësi e kulluar) e kuptimit artistik. Pastaj: ky njeri në fushën e bardhë, madje lakuriq fizikisht e shpirtërisht, pra baras me të shkrep tën, me shkretëtirën. Ngjyra e *bardhë*, kaq e pranishme në këtë tekst poetik, shënjon asnjësinë e njeriut, ku mundësia e realizimit të tij gjendet në shkallën zero të ekzistimit, siç do të thoshte filozofi dhe kritiku francez Roland Barthesi (Roland Bart).

Me këtë Podrimja sjell një *gjysmëbotë*, një *gjysmënjeri*. Mungon bota e plotë, të cilën e do dhe, e kërkon përmbushja e saj në mungesë. Do shenja të vërteta, të plota, ekuivalentet me gjërat, me fjalët dhe me kuptimet.

Këto universalie poetike i nxjerr nga sfera të ndryshme të ekzistimit: në atë historike dhe në atë bashkëkohëse, pastaj në planin e përvojës së kombit të vet dhe të përvojës së përgjithshme historike e filozofike. Duke konstatuar dhe duke dhënë torzionin në këto plane, ai thujse e barazon atë dhe e gjen si prani të përhershme në të dy kontekstet kohore të sipërpërmendura. Dhe le të shohim lidhjen e këtyre dy konteksteve në vepër. Konkretisht:

*e kobërat sytë  
njëra tjetrës ia nxorën  
me esbtrat tanë*

## (KOHË E GURIT)

*ti je i vetmi kujtim nga antika  
kuptim as ngjyrë s'ke humbur*

-----  
*ketheu në vargun e Homerit*

(KALI I TROJËS)

*në këtë fushë të bardhë njerinë vallë si e harruam*

(SI E HARRUEM...)

*Planeti bosh e kokat plot varre*

(LOJA E PAKRYER)

*fjalët e humbën fuqinë magjike  
kur kurrkush më s'mendon me kokë të vet*

(PËR DASHURI TË REJA...)

I sollëm këto vargje, sepse e gjithë poezia e këtij libri është mendim autonom dhe e maksimalizuar kuptimisht, sa që edhe mendimi më i mirë thënë për shpjegimin e tyre, nuk i kapërcen kursesi. Dhe është gjë e mirë kur aparati i analizës nuk arrin ta shtrojë artin. Thënë ndryshe, poeti ia del të na japë traumatikën e botës në vazhdimësi dhe tjetërsimin e saj si fenomen në kohën e inflacionit të vlerave të fjalës, të mendimit dhe të veprimit. Pra ai reagon poetikisht, madje mjaft me sukses.

#### *4. Midis Idesë dhe Konstatimit*

Zakonisht në analizën e një diçkaje kemi dy tipe vlerësimesh: ato që nisen nga Ideja dhe e japin idenë në mosrealizimin e saj, që na duken gjithmonë më interesante dhe më vizionare, më të këndshme dhe më të bukura, prandaj i duam dhe duam të fundohemi atje si dhe ato vlerësime që nisen nga Realja, që shpesh nuk na kënaqin dhe na sjellin zymtësi e brenga të tjera.

Mirëpo, mendimi bashkëkohës teorik mbi këto fenomene, nuk i ndan këto dy pikënisje, po i merr si komplementare përngatendimi. Si duket këtë na e jep edhe poezia e *Torzos* së Podrimjes. Shkurt, poeti duke dhënë dhe duke analizuar torzionin e gjithhershëm të ekzistimit të botës dhe të njeriut, arrin në konstatime të hidhura, që i metaforifikon me emërtimin Torzo. Madje para torzos poetike të poetit arrijmë vetëdijen për figurën komplete të njeriut dhe të botës. Elementet e kësaj poezie na i përkujtojnë figurat minimale, në çdo aspekt, të Giacomettit, që mund t'ë lidhim me atë konceptcionin skulptural të poetit të përmendur diku në fillim të kësaj fjale, i cili atij i ka shërbyer si pikënisje dhe si finalizim i rezultateve të konstatimeve të tij poetike.

Fund i fundit, poeti nuk do torzo, po figura, qenie komplete. Idealizëm i bukur poetik e artistik! Por, si gjithmonë kur është fjala për funksionin e artit, i nevojshëm dhe fisnikërues...

*Prishtinë, janar 1979*

*Ibrahim Rugova*





# PËRMBAJTJA

<b>HIJA E TOKËS</b> .....	7
I.....	9
Epika.....	9
Unë, biri yt.....	10
Shtëpia ime pa qetësi.....	11
Ikën pëllumbat.....	12
Hija e tokës.....	13
Ankthi.....	15
Përtej dhembjes.....	16
I panjohuri.....	17
Toka jonë e fëmijëve tanë.....	18
Revolucionet.....	19
Rrëfimi.....	20
Rënkimi.....	21
Ninullë guri.....	23
Mallkimi.....	24
Një natë nga netët pa gjumë.....	25
II.....	27
Zogu.....	27
Kah rridhte gjaku.....	28
Qeni im ka lehur në shushurimën e plepave.....	29

Varre lanë pas .....	30
Gjelit tim pendlat ju ndërruan.....	31
Pas kokës sime.....	32
Gjerësitë e jetës i përflaku ngjyra e përrallave.....	33
III. ....	34
Bjeshka dhe njeriu.....	34
Era fryn.....	35
Unë ik prej shiut.....	36
Tehut të shpatës marshuam.....	37
Emri i gdhendur në gurë.....	38
Dita e parë, dita e mbramë .....	39
IV. ....	40
Mëngjesi.....	40
E pakufi je si shpirti im .....	41
Në udhëtimin tim të kam zbuluar.....	42
Dua të jem.....	43
Edhe.....	44
Drini i Bardhë.....	45
Nata.....	46
Lindja e madhe .....	47
Lutja ime.....	48
Luftëtari.....	49
V. ....	50
Në mes meje e Kosovës.....	50
Në udhëtim edhe një dashuri .....	51
Voglushi im me emër të çuditshëm.....	52
Betimi.....	53
Epilogu ose biseda e një poeti me vetveten .....	54

<b>TORZO</b> .....	55
Maca e zezë.....	57
<b>KOHA E GURIT</b> .....	58
Rozafati.....	58
Koha e gurit .....	59
Balada për dhëmbin e ujkut.....	60
Rreth nesh e botës .....	62
Emrat tanë.....	63
Si të këndojmë kur gjithçka liruam .....	64
<b>KALI I TROJËS</b> .....	65
Ai është në mes të njerëzve .....	65
E ti s’i harrove asnjëherë.....	66
Pas shkundullimës gjurmat t’i fshijnë.....	67
Më i ri mbete se ishe .....	68
Ktheu në vargun e Homerit .....	69
<b>POEMA E HESHTJES</b> .....	70
Emra ka harruar .....	70
Në nofulla të një kohe heshtjen përtypim .....	71
Metafora e jetës sime .....	72
Eci rrugës sime ajo më ndjek pas.....	73
Kur dashurohem në fuqinë e rrufesë .....	74
Si e harruam njerinë në fushën e bardhë .....	75
Shiu dhjetë vjet s’pushon në një legjendë.....	76
Shtat lëshon një lullkuq .....	77
Një ditë .....	78
Pas rënjes pas ngadhënjimit.....	79
<b>HIJA NË PASQYRË</b> .....	80
Balada për njerinë që shetit lakuriq nëpër botë .....	80
Loja e pakryer .....	81

Gjithkund po më ndjek shiu dhe heshtja .....	83
Zotit i lutet e zoti e pështyn .....	84
Maska .....	85
Hija në pasqyrë .....	87
<b>TORZO .....</b>	<b>88</b>
Ç'po ndodh me mua .....	88
Me një trëndafil në dorë .....	89
Unë eci shiu bie .....	90
Zotin pahiri e krijova njëherë .....	92
Torzo .....	93
Ngjyrat e harrimit .....	94
Ma thuani emrin .....	95
<b>PËR DASHURI TË REJA JETA ËSHTË TEPËR E VJETËR ..</b>	<b>96</b>
Vonë do të vdesë kjo stuhi në bredhje .....	96
Kurrë atë emër .....	97
Nata e kujtimeve .....	98
Të kam pasë thënë një ditë .....	99
Ekstaza .....	100
Deshta njëherë një dashuri .....	102
Për dashuri të reja jeta është tepër e vjetër .....	103
<b>NË PARALELEN IKS PËLCET NJË BOMBË .....</b>	<b>104</b>
Shiu .....	104
Njeriu ku mbet .....	105
Duke kërkuar njerinë .....	106
Përralla .....	107

<b>FOLJA</b> .....	109
Koka e humbur në krosin automobilistik.....	111
<b>PYLLI</b> .....	113
Është një pyll .....	113
Baladë mbi sopatën.....	115
Baladë mbi bishtin .....	116
Zjarri .....	117
Kronika të kalorësve të zez.....	118
Një fyell e një yll në një pyll.....	119
Kashë e lashë .....	120
<b>NJERIU I BARDHË NJERIU I ZI</b> .....	121
I. Njeriu i bardhë njeriu i zi .....	121
II. ....	123
III. ....	125
IV.....	126
V. ....	127
VI.....	128
<b>KËNDEJ E ANDEJ SYRIT T'FYELLIT</b> .....	130
Sëmundja e familjes sime 1-4 .....	130
Në gjah.....	134
Te ishulli larg vetes.....	135
Koka e artë 1-2 .....	136
<b>E FYELLI KËNDON PA I RËNË KUSH</b> .....	138
Koha ime 1-2 .....	138
Dhëmb i zi .....	140
Etjet.....	141
Flaka e vjedhur .....	143
E fyelli këndon pa i rënë kush.....	144
Loja e fatit .....	145

Buzëqeshja .....	146
<b>TRIUMFI</b> .....	147
Ishulli i vdekjes .....	147
Apokalipsa.....	148
Pa folje.....	149
Ëndrra do t'më zgjojë.....	150
Në rojën e vdekjes .....	151
Bukur është .....	152
Triumfi.....	153
Rebelimi.....	154
Kredo .....	155
<b>EMRAT E SHKIMBUR</b> .....	156
Bibla .....	156
Karrigia .....	157
Baladë blerake.....	158
Spiralja .....	159
Emrat e shkrimbur.....	160
Një bukuri e paparë .....	161
<b>NJERIU ME PLAGË NË KOKË</b> .....	162
Njeriu me plagë në kokë .....	162
<b>CREDO</b> .....	163
<b>FISHKËLLON E KAFSHON</b> .....	165
E guri im rrokulliset.....	165
<b>BARDHË</b> .....	166
Ishulli .....	166
Valore.....	167
Bardhë.....	168

E SYRI TË ZMADHOHET.....	169
Cung i vetëm në pyll.....	169
II.....	170
III.....	171
IV.....	172
V.....	173
VI.....	174
NË NJË PLANET TJETËR BIE TI.....	175
Guri.....	175
II.....	178
Droja.....	182
Loja e dritave.....	183
E pa-njohura.....	184
SE ÇDO GJË NDIHET ÇDO GJË SHIHET.....	185
Kulla.....	185
II.....	186
III.....	187
IV.....	188
V.....	189
ËNDRRA QË VAZHDON.....	190
Ëndrra që vazhdon.....	190
Mashtrimi.....	191
Hapësia.....	192
Dyshimi.....	193
Mortale.....	194
E pakryera.....	195
DËFTORE.....	196
Dëftore.....	196
TRAUMATIKA E BOTËS DHE TJETËRSIMI I SAJ.....	201

ALI PODRIMJA

# VEPRA

Vëllimi i tretë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 13.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 3 : Hija e tokës ; Torzo ; Credo ; Folja. - 216 f.,  
portreti i autorit

Traumatika e botës dhe tjetërsimi i saj / Ibrahim Rugova : f. 201-207

**ISBN 978-9951-615-14-3**

**ISBN 978-9951-615-17-4**